



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:254576

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06453027

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0740-A0001

Paditëse/Ankuese

B H me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin B I, Prishtinë

Kundër:

E paditura

N.SH. “Pasuria Bujqësore”, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1725, të datës 14 nëntor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 nëntor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paditëses është e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1725, i datës 14 nëntor 2023 si dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI011-0075 të datës 11 tetor 2013.
3. Obligohet e paditura që në emër të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës t’i paguaj paditëses shumën prej 847.00 euro, interesin ligjor prej 10% në shumën prej 84.70 euro si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 104.00 euro, e të gjitha këto sipas prioritetëve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 14 nëntor 2013, paditësja me grupin e punëtorëve kishin ushtruar ankesë në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe kjo lëndë ishte e regjistruar me numrin C-IV-13-3128. Pas ndarjes së rastit për paditësin lënda ka marrë numrin C-IV-15-1725.

Me datë 14 shtator 2015, paditësja kishte paraqitur një parashtrësë për rregullimin dhe plotësimin e padisë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI011-0075 të datës 11 tetor 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditëses për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, interes dhe kontribute pensionale në shumën prej 847.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit. Paditësja me parashtrësë i kishte propozuar gjykatës që të miratohet në tërësi padia e paditëses dhe të anulohet vendimi i të paditurës GJI011-0075 të datës 11 tetor 2013 dhe të obligohet e paditura që në emër të kompensimit të borxhit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës t'i paguaj paditëses shumën prej 847.00 euro me interes ligjor prej 10% si dhe të obligohet e paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në vlerë prej 104.00 euro.

Parashtrësës i kishte bashkëngjitur këto prova: kopjen e librezës së punës së paditëses, formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, vendimin e ankimuar të AL-së me nr. GJI011-0075 të datës 11 tetor 2013, padinë bashkë me plotësimin e padisë nga ana e paditëses e dorëzuar në DHPGJS si dhe një email me subjekt Dokumentacionin për punëtorët e N.SH “Pasuria Bujqësore” të datës 31 mars 2023.

Me datë 18 prill 2023, AKP-ja e kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesja nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2. të Ligjit për DHPGJS-në i cili parashikon se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në.

Sipas AL kërkesa e paditësit do të duhej të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI011-0075 të datës 11 tetor 2013, vendimin për emërimin e anëtarëve të AL-së si dhe Regjistrin e punëtorëve që punojnë dhe gëzojnë të ardhura

personale për muajin Tetor 2006 të kërkuar nga Zyra Regjionale e AKM-së në Gjilan nga qiraja e paguar nga qiragjinjët e ndërmarrjes, e datës 16 tetor 2006.

Me datë 14 nëntor 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1725 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se paditësja nuk ka dorëzuar provë që ajo ka qenë e regjistruar në regjistër të punëtorëve si dhe ka realizuar pagë përkundër faktit se librezja e punës i është mbyllur me datë 22 qershor 2009. Gjykata kishte vlerësuar se në rastin konkret paditësja nuk ka provuar faktin se në ditën e mbylljes së Librezës së punës të datës 22 qershor 2009, paditësja ishte duke punuar tek e paditura dhe se deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ardhur me veprimin e AKP-së por përkundër këtij fakti paditësja nuk ka provuar faktin se në ditën e privatizimit të N.SH-së ajo ishte në regjistër të punëtorëve dhe të pagave për periudhën prej vitit 2006 deri në 2009, pra ajo nuk ka pasur statusin e punëtorit aktiv në N.SH.

Gjithashtu duke u bazuar në regjistrin e punëtorëve të lëshuar nga N.SH të datës 16 tetor 2006, të nënshkruar nga drejtori H S, paditësja nuk ishte në regjistër të punëtorëve. Andaj, gjykata kishte vlerësuar se pretendimi i të paditurës është i qëndrueshëm sepse paditësja nuk ishte punëtorë aktive në kohën e privatizimit dhe e njëjta nuk ka bazë juridike të kërkoj dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës.

Me datë 7 dhjetor 2023, paditësja (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-15-1725 të datës 14 nëntor 2023 (aktgjykimi i ankimuar), për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit që të miratohet në tërësi si e bazuar ankesa e ankueses ose të prishët Aktgjykimi i ankimuar ashtu që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës t'i paguaj paditësit shumë prej 847.00 euro, interesin ligjor prej 10% si dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit. Në ankesë theksohet se me hapjen e procedurës së likuidimit ftohen të gjithë kreditorët, punëtorët të cilët kanë pretendime se N.SH u ka mbetur borxh, pra ka obligime të pa përmbushura ndaj tyre që të plotësojnë formularët e kërkesave dhe të njëjtat ti dorëzojnë pranë AL-së në rast se refuzohen kërkesat e tyre në afatin e përcaktuar ligjor të njëjtit mund t'i drejtohen DHPGJS-së në çështjet në lidhje me AKP-në.

E paditura ishte e obliguar që për çdo kontratë apo marrëdhënie të përhershme të punës e cila është ndërprerë si rezultat i privatizimit të njoftonte zyrtarisht punëtoreshën për ndërprerjen e

marrëdhënies së kontratës së punës dhe këtë detyrë ajo e kishte realizuar duke lëshuar një dokument zyrtar- Letër Pezullimin me të cilin njofton punëtoren me arsyet e ndërprerjes së parakohshme të kontratës dhe merrte përsipër përgjegjësinë-detyrimet e deri atëherëshme. Në rastin konkret janë lëshuar një numër i madh i letër pezullimeve thuajse për të gjithë punëtorët mirëpo nuk e kemi të njohur faktin se pse AL-ja ju ka lëshuar këto Letër pezullime vetëm disa punëtorëve dhe jo të gjithëve ashtu siç ishte e obliguar. Andaj, ankuesja kishte kërkuar nga gjykata që të ketë parasysh këtë fakt/rrethanë me qëllim që punëtorët të mos pësojnë për shkak të veprimeve të paligjshme të AKP-së dhe duke përdorë dy standarde lidhur me punëtorët, andaj i propozon Kolegjit të Apelit që të miratoj kërkesëpadinë e paditëses.

Me datë 23 gusht 2024, e paditura (AKP) kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses në të cilën i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e paditëses aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1725, i datës 14 nëntor 2023 si dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI011-0075 të datës 11 tetor 2013 duhet të ndryshohen.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditëses për dëmshpërblim në emër të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 847.00 euro nga N.SH. “Pasuria Bujqësore”, ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se afati kohor kur paditësja kishte parashtruar kërkesën e saj për realizimin e së drejtës së saj të pretenduar, e njëjta ishte parashkruar.

Paditësja në ankesën e tij të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI011-0187 të datës 11 tetor 2013, kishte bashkëngjitur provat si në vijim: kopjen e librezës së punës së paditëses, formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, vendimin e ankimuar të AL-së me nr. GJI011-0075 të datës 11 tetor 2013, padinë bashkë me plotësimin e

padisë nga ana e paditëses e dorëzuar në DHPGJS si dhe një email me subjekt Dokumentacionin për punëtorët e N.SH “Pasuria Bujqësore” të datës 31 mars 2023.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses me arsyetim se e njëjta nuk ka provuar faktin se në ditën e mbylljes së Librezës së punës të datës 22 qershor 2009, paditësja ishte duke punuar tek e paditura dhe se deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ardhur me veprimin e AKP-së.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së nuk kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e paditëses është e bazuar.

Kjo për faktin se nga kopja e Librezës së punës së paditëses shihet që paditësja kishte ofruar shërbime pune për N.SH-në nga dhjetori 1989 deri me 22 qershor 2009, kur të njëjtës i është mbyllur librezja e punës më rastin e privatizimit të ndërmarrjes në fjalë.

Letër pezullimi si dokument me të cilën do të vërtetohej ndërprerja e parashkrimit në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës mund të parashtrohej nga paditësja vetëm në rast të dorëzimit nga ana e AKP-së . Në të kundërtën paditësja nuk mund të parashtroi një dokument të tillë . Në rastin konkret i mbetet AKP-së të vërtetoi se vërtet paditëses i kishte dorëzuar një dokument të tillë apo jo të cilën nuk e ka bërë.

E nga kjo rrjedh se paditëses i ka përfunduar marrëdhënia e punës si rezultat i veprimit/vendimit të AKP-së çka e bën kërkesën dhe pretendimet e paditëses të bazuara.

Andaj, Kolegji i Apelit vlerëson se paditësja mjaftueshëm e kishte dëshmuar të drejtën e saj dhe konstaton se paditëses duhet t’i njihet e drejta në kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën e kërkuar prej 847.00 euro, e cila shumë do t’i paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Vlen të theksohet se shumën e kërkuar nga paditësja nuk e kishte kontestuar asnjëherë e paditura. Andaj faktet e pakontestuar konsiderohen si të vërtetuara.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja përveç borxhit kryesor kishte kërkuar edhe interesin ligjor. Bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, paditëses i njihet edhe e drejta në interesin ligjor prej 10% ose në shumën 84.70 euro e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Pasi që pala e paditur është palë e pasuksesshme në këtë lëndë, bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore lidhur me përfaqësimin nga ana e avokatit në shumë prej 104.00 euro, që po ashtu do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e paditëses aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
